



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 12.02.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1773/24, për përfituesit e subvencioneve për vitin 2024 në Komunën e Deçanit: Avni Rexha (OJQ - Klubi Futbollistik "Deçani"), Zeqë Malaj (OJQ -Fondacioni "Dhuro edhe ti"), Ajne Iberhysaj (OJQ – "Iniciativa për Zhvillim"), Bajram Çekaj (OJQ - Grupi Lokal i Veprimit "Gjeravica"), Miftar Januzaj (OJQ - Organizata për Mbledhjen Ruajtjen dhe Konzervimin e Eksponateve Antika), dhe Mustafë Ramaj (OJQ - "Dervish Shaqa"), për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për përfituesit e sipërpërmendur është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), me pretendimet për konflikt të interesit, pasi që (citojmë nga kërkesa): "[...] Në një thirrje për subvencione kanë përfituar disa zyrtarë/punonjës të Komunës së Deçanit përmes OJQ-ve të tyre. [...]".

Me qëllim të sqarimit të plotë të këtij rasti, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka kërkuar dhe siguruar informacion/dokumentacion plotësues nga Komuna e Deçanit dhe pas shqyrtimit dhe analizimit me kujdes të të gjithë informacionit/dokumentacionit në dispozicion, ka konstatuar faktet si në vijim:

Sipas shkresës zyrtare APK-DPKI-88/25, të dërguar nga Komuna e Deçanit, rezulton se në listën e përfituesve të subvencioneve të OJQ-ve dhe Klubeve Sportive ka edhe zyrtarë publik, përkatësisht nëpunës të shërbimit civil, si:

[...]

Avni Rexha - OJQ - Klubi Futbollistik "Deçani", më pozitë punë: Shefi i Sektorit për Kulturë, Rini dhe Sporte, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;

Zeqë Malaj - OJQ - Fondacioni "Dhuro edhe ti", me pozitë pune: Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët, në kuadër të Drejtorisë për Arsim;

Ajne Iberhysaj - OJQ - "Iniciativa për Zhvillim", me pozitë pune: u.d. Udhëheqës i Sektorit për Inspeksione, në kuadër të Drejtorisë për Inspeksione;

Bajram Çekaj - OJQ - Grupi Lokal i Veprimt "Gjeravica", me pozitë pune: Shefi i Sektorit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;

Miftar Januzaj - OJQ - Organizata për Mbledhjen Ruajtjen dhe Konzervimin e Eksponateve Antika, me pozitë pune: Portir në kuadër të Drejtorisë për Administratë; dhe

Mustafë Ramaj - OJQ - "Dervish Shaqa"; me pozitë pune: Zyrtar i Muzeut, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte. [...]"

Sipas vendimit (Nr. 2137, dt.: 12.03.2024), për formimin e Komisionit për Shqyrtimin e Aplikacioneve të Thirrjes Publike Subvencionim të OJQ-ve dhe Klubeve Sportive, asnjë nga përfituesit e sipërpërmendur të subvencioneve nuk rezultojnë të kenë qenë pjese e Komisionit apo të jenë përfshirë në ndonjë vendimmarrje në gjithë procesin e ndarjes së këtyre subvencioneve.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të gjithanshëm të të gjitha informacionit dhe dokumentacionit në dispozicion, konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konstaton se në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përkitazi me përfituesit e sipërpërmendur të subvencioneve të OJQ-ve dhe Klubeve Sportive.

Me dispozita të caktuara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, janë përcaktuar kufizime, ndalesa, papajtueshmëri, përkatësisht situata të konfliktit të interesit për zyrtarë publik gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre publike.

Prandaj, varësisht statusit të zyrtarit publik (nëse janë persona zyrtar apo zyrtarë të lartë në kuptim të Ligjit përkatës për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë), zbatohen dispozita përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka pasur parasysh dispozitat e nenit 14 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se:

"1. Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to.

2. Organizata joqeveritare sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk ka të drejtë të lidhë kontratë ose të përfitojë fonde nga institucioni ku ushtron detyrën zyrtari që është anëtar i organit drejtues në këtë organizatë".

Por, në rastin konkret, përfituesit e sipërpërmendur të subvencioneve nuk rezultojnë të jenë zyrtarë të lartë sipas ligjit përkatës për deklarimin e pasurisë, prandaj dispozitat e sipërcituara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nuk mund të aplikohen në rastin konkret.

Prandaj, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstaton se në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit për përfituesit e sipërpërmendur të subvencioneve nga Komuna e Deçanit, pasi që të njëjtit përveç se nuk janë zyrtarë të lartë sipas ligjit përkatës për deklarimin e pasurisë Nr.08/L-108, të njëjtit nuk kanë qenë të përfshirë në ndonjë vendimmarrje në procesin e ndarjes së këtyre subvencioneve.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

Ylli Buleshkaj
Drejtör i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

- Zyrtarëve publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)